



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Mënyrat e Dërgimit të Remitancave në Kosovë

P r i l l 2 0 1 3

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Mënyrat e Dërgimit të Remitancave në Kosovë

BOTUES ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Sistemit të Pagesave
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE paymentsystems@bqk-kos.org

Gjylfidane Kastrati-Kadrijaj, Drejtore e Departamentit të
Sistemeve të Pagesave
Masar Baxhaku, Zyrtar për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave

Shkurtesat

ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transfer të Parave
BB	Banka Botërore
BIS	Banka për Shlyerje Ndërkombëtare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DSP	Departmaneti i Sistemit të Pagesave
GPVF	Grupi Punues për Veprimtarinë Financiare
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KSPSH	Komiteti Mbi Sistemet e Pagesave dhe Shlyerjes
OSHR	Ofruesit e Shërbimit të Remitencave
POS	Pika e Shitjes (angl. Point of Sale)
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
SWIFT	Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunications
SZHSKP	Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave

INFORMATË:

Për përshkrim të detajuar, referohuni shënimeve sqaruese.
Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
Remitancat në Kosovë, Prishtinë 2013.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.
Ky publikim përfshin të dhëna në dispozicion deri më 31dhjetor2012.

PËRMBAJTJA

HYRJE	06
1. Dërgesat e emigrantëve-Remitancat	08
1.1. Rëndësia e dërgesave nga emigrantët në zhvillim ekonomik	08
1.2. Ofruesit e shërbimeve të remitancave	08
1.3. Pjesëmarrësit në transferin e remitancave	09
1.4. Llojet e shërbimit të remitancave	09
2. Analiza e çështjeve kyçe lidhur me shërbimin e remitancave	10
2.1. Mungesa e transparencës dhe mirëkuptimit	10
2.2. Çështjet e Infrastrukturës	11
2.3. Kuadri ligjor dhe rregullativ	11
2.4. Mungesa e kushteve konkurruese në treg	12
2.5. Rreziku	12
3. Parimet e përgjithshme të remitancave	13
3.1. Objektivat e politikave publike	13
3.2. Aplikimi i parimeve bazë	13
3.3. Parimet bazë	13
3.3.1. Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorëve	13
3.3.2. Infrastruktura e sistemit të pagesave	14
3.3.3. Mjedisi ligjor dhe rregullativ	14
3.3.4. Përbërja e tregut dhe konkurrenca	15
3.3.5. Qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut	15
3.4. Roli i agjencioneve për transfer të parave dhe autoriteteve publike	15
3.5. Formulimi i qasjes për implementim të parimeve të përgjithshme	16
4. Situata aktuale e remitancave në Kosovë	17
4.1. Ecuria e zhvillimeve dhe kanalet e transferit të parasë	17
4.2. Forma formale e dërgimit të remitancave	18
4.3. Forma jo-formale e dërgimit të remitancave	22
4.4. Remitancat sipas kanaleve të pranimit	23

4.5. Vendet dërguese të remitancave	25
5. Rekomandime	28
Bibliografia	30

PREZANTIMI GRAFIK

1. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes agjencioneve për transfer të parave	21
2. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes llogarive bankare	23
3. Remitancat sipas kanaleve të dërgimit	25
4. Remitancat sipas viteve	26

TABELAT STATISTIKORE

1. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes ATP-ve	19
2. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes llogarive bankare	21
3. Remitancat sipas kanaleve të dërgimit	23
4. Remitancat e shprehura në përqindje të vlerës së përgjithshme të remitancave në bazë të shteteve dërguese	14

Hyrje

Dërgesat e emigrantëve janë një nga burimet më të rëndësishme dhe të qëndrueshme të financimit të jashtëm për vendet në zhvillim. Në dy dekadat e fundit, dërgesat e emigrantëve kanë arritur nivelin e investimeve të huaja direkte (IHD). Në shumë vende në zhvillim, dërgesat e emigrantëve janë edhe më të larta se ndihma nga asistenca e huaj. Ato mbesin të rëndësishme veçanërisht për vendet më pak të zhvilluara, me deficite kronike të mëdha tregtare, duke e zvogëluar këtë hendek. Dërgesat e emigrantëve gjithashtu janë në mesin e burimeve më të qëndrueshme për rezervat e huaja, si dhe shpeshherë me një efekt kundërciklik duke nxitur konsumin dhe në masë më të vogël investimet gjatë recesionve. Duke pas parasysh rëndësinë e dërgesave të emigrantëve, vende të ndryshme kanë ndërmarrë politika dhe iniciativa për ngritjen e efikasitetit dhe integritetit ,në ofrimin e shërbimeve të dërgesave të emigrantëve

Ngjashëm me vendet tjera, dërgesat e emigrantëve janë të një rëndësie të veçantë edhe për ekonominë e Kosovës. Dërgesat e emigrantëve në Kosovë paraqesin njërin ndër burimet kryesore të financimit të konsumit të ekonomive familjare dhe paraqesin një burim, që siguron gjendje stabile sociale duke zvogëluar ngarkesën ndaj buxhetit shtetëror.

Sidoqoftë, sfiduese për ekonominë e Kosovës vazhdon të mbetet kanalizimi i dërgesave nëpërmjet rrugëve formale, sidomos bankave.

Në këtë drejtim, Banka Qendrore në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave, do të angazhohet direkt në përkrahjen pa rezervë për iniciativat e ndërmarrja, në drejtim të përkrahjes së transfereve formale nga bankat komerciale dhe agjensionet për transferimin e parave por edhe nga institucione qeveritare e përfaqësitë diplomatike, në vendin tonë dhe organizatave tjera joqeveritare.

Në këtë kuadër, një prej këndvështrimeve kryesore në këtë studim do të jetë paraqitja e rolit dhe rëndësisë së kanalizimit të kësaj kategorie të pagesave “dërgesave të emigrantëve” në rrugët formale, duke synuar kështu gjetjen e instrumenteve më të volitshme, efikase, të sigurta, të shpejta dhe me kosto sa më të ulët, si për dërgim ashtu edhe pranim, të këtyre pagesave të diasporës sonë. Për më tepër objektivi i këtij studimi është edhe të prezantohet situata aktuale e dërgesave të emigrantëve, diskutim mbi praktikën dhe politikën e përshtatshme bazuar në eksperiencat e shteteve tjera dhe implikimet potenciale për ekonominë e Kosovës.

Për të ndihmuar në këtë drejtim, Banka Botërore dhe Komiteti mbi Sistemet e Pagesave dhe Shlyerjes (KSPSH), kanë formuar një grup punues për t'i adresuar nevojat e koordinimit të politikave ndërkombëtare për dërgesat e emigrantëve. Në kuadër të këtij grupi punues akterët kryesorë janë Bankat Qendrore nga shtetet dërguese dhe pranuese të remitancave, institucionet ndërkombëtare financiare dhe bankat zhvillimore. Ky grup

punues ka identifikuar Parimet e Përgjithshme për Shërbimet e Dërgesave Ndërkombëtare në janar 2007.

Nga perspektiva e bërjes së politikave, pagesat ndërkombëtare me vlera të vogla kanë karakteristikat pothuaj se të njëjta me pagesa vendore me vlera të vogla. Megjithatë, dërgesat ndërkombëtare mund të jenë të shtrenjta në raport me shumën e dërgesave të emigrantëve, që në të shumtën e rasteve dërgohen në shuma të vogla (zakonisht jo më shumë se disa qindra euro). Gjithashtu, për emigrantët mund të mos jetë e lehtë qasja në shërbimet financiare si rezultat i njohurive të përgjithshme (edukimit financiar), si dhe në rast se ata nuk flasin gjuhën e vendit ku ata jetojnë, por edhe nëse nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm. Në anën tjetër, vështirësi në aspektin financiar mund të paraqesë edhe edukimi financiar në vendin e pranimin, infrastruktura financiare relativisht e pazhvilluar, gjë e cila mund t'iu vështirësojë marrësve pranimin e dërgesave nga emigrantët. Veç kësaj, disa tregje shpesh konsiderohen se kanë mungesë të konkurrencës apo kanë barriera rregulluese për ofrimin e shërbimeve për dërgesat e emigrantëve.

1. Dërgesat e emigrantëve-Remitancat

Remitancat klasifikohen në dy kategori kryesore: të brendshme dhe të jashtme. Remitancat e brendshme janë atëherë, kur ka migrim nga zonat rurale në ato urbane brenda vendit për shkak të mundësive më të mira për punësim. Megjithatë në këtë raport fokusi është në remitancat ndërkombëtare, të cilat për qëllim të këtij studimi, janë përcaktuar si pagesa ndërkufitare në vlerë të vogël mes personave nga njëri vend në tjetrin¹. Në praktikë remitancat janë pagesa të rregullta të emigrantëve (punëtorët të cilët dërgojnë para në familjet e tyre në vendin e origjinës). Për thjeshtim në pjesën tjetër të këtij studimi pagesave të tilla do t'iu referohemi si “transfera të remitancave”, që nënkuptojnë transferat ndërkombëtare. Në numrin më të madh të rasteve, remitancat janë transfere mes personave që jetojnë në vende më të zhvilluara dhe atyre në vende në zhvillim, pra edhe me standarde më të ulëta jetese. Qëllimi i këtyre transfereve është kryesisht për të siguruar kushtet e jetesës e rrallëherë për qëllime përfitimi.

Në vendet në zhvillim, dërgesat e emigrantëve zënë një vend mjaft të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale të tyre. Edhe Kosova si çdo vend tjetër në zhvillim ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të saj, që jetojnë në vende tjera më të zhvilluara (kryesisht në Bashkimin Evropian). Duke ditur numrin e lartë të të papunëve në Kosovë, nga vitet '90 e tutje, kanë qenë remitancat ato që kanë siguruar kushtet e jetës për shumë nga qytetarët e Kosovës.

1.1. Rëndësia e dërgesave nga emigrantët në zhvillim ekonomik

Duke pasur parasysh se dërgesat e emigrantëve përbëjnë një element të rëndësishëm të të ardhurave kombëtare, si dhe komponentë mjaft e rëndësishme në financimin e konsumit, rrjedhimisht me kontribut edhe në rritjen ekonomike, studimi i kësaj kategorie konsiderohet mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës.

Dërgesat e emigrantëve, janë gjithnjë e më shumë relevante për ekonominë dhe shoqëritë si rezultat i realiteteve aktuale globale, veçanërisht integritet ekonomik në rritje dhe ndërvarësisë ndërmjet shteteve, në të gjitha nivelet dhe lëvizjes në rritje të emigrantëve në tërë botën.

¹ CPSS/World Bank-General principles for remittances- January 2007

1.2 Ofruesit e shërbimeve të remitancave

Emigrantët për dërgimin e mjeteve të tyre përdorin disa rrugë duke filluar nga bartja e mjeteve kesh nga vendi ku punojnë, deri në vendin e tyre apo edhe mënyra më e avancuar përmes transfereve bankare. Në këtë raport do të fokusohemi në transferet ,që bëhen përmes agjencioneve apo bankave të ndryshme, ndërsa bartja e mjeteve kesh nga një vend në tjetrin nuk do të analizohet edhe për shkak të mungesës së të dhënave për këtë formë të transferit. Në vijim të këtij raporti, institucioneve që ofrojnë shërbimin e transferit të parave do t'iu referohemi si Agjencione për Transferimin e Parave (ATP).

1.3 Pjesëmarrësit në transferin e remitancave

Në procesin e transferit të mjeteve të emigrantëve nga një vend në tjetrin janë të përfshira këto palë: dërguesi, pranuesi dhe agjencioni për transfer të parave. Në të shumtën e rasteve në një transfer janë të përfshirë dy ATP: njëra në vendin e destinacionit ndërsa tjetra në vendin e origjinës. Këto dy ATP duhet të bashkëpunojnë mes veti në mënyrë që të mundësohet transferi i mjeteve, ku ATP e dërguesit duhet të dërgojë mesazhin te ATP e pranuesit me të dhënat përcjellëse siç janë: personi që i dërgon paratë, vendi nga dërgohen, shuma, si dhe personi që do t'i pranojë paratë etj. Shpesh ATP-të nuk kanë lokacione fizike të tyre por përmes agjentëve kryejnë aktivitetet e tyre. Më së shpeshti bankat dhe unionet kreditore e kryejnë funksionin e transferit dhe shpërndarjes së mjeteve të klientët pranues.

Duke analizuar mënyrën se si kryhet transferi, mund të thuhet se shumica e remitancave janë transfere të kreditit, që do të thotë se çdo transfer inicohet me urdhër të dhënë nga dërguesi i mjeteve në ATP². Procesi i transferit të mjeteve përfshin transferin e fondeve dhe informatave njëkohësisht nga ATP-ja e dërguesit deri te ATP-ja e pranuesit (dërguesi duhet t'i japë informatat institucionit të transferit në mënyrë, që t'i dërgojë mjetet deri te pranuesi dhe institucioni/personi që shpërndan paratë, pranuesit mund t'i tregojë se kush është personi që ka dërguar paratë).

1.4. Llojet e shërbimit të remitancave

Në mënyrë që shërbimi i remitancave të funksionojë, duhet që të ekzistojë një lloje “lidhje” që do të thotë pikat ku fondet do të pranohen dhe dorëzohen dhe procedurat për të bërë lidhjen e këtyre pikave për të mundësuar dërgimin e mesazheve dhe kryerjen e shlyerjes. Lokacionet ku kryhen këto procedura ose mund të jenë në pronësi të vet ofruesve të këtyre shërbimeve

² CPSS/World Bank-General principles for remittances- January 2007

ose nën pronësi të agjentëve të cilët bëjnë shpërndarjen e mjeteve. ATP-të mund të ndahen në këto kategori³:

- Shërbime një palëshe- që nënkupton se i tërë procesi i transferit të mjeteve kryhet nga ana e vetëm një agjencioni për transfer të mjeteve. Kjo mund të ndodhë në rastet kur agjencioni përkatës ka pikat fizike, si në vendin e origjinës ashtu edhe në vendin e destinacionit.
- Shërbimet në formë franshize- në rastet kur një agjencion qendror, pa pasur nevojë që të ketë pikat e tij fizike, ofron shërbim si pronar, agjencioni qendror krijon infrastrukturën për kryerje të transferit (psh, dërgimin e mesazheve dhe kryerjen e shlyerjes apo edhe marketingun) por zgjedh pikat fizike të nevojshme, si në vendin e origjinës ashtu edhe në vendin e destinacionit përmes përcaktimit të institucioneve të cilat do të punojnë nën franshizën e tij pasi të jenë përcaktuar kushtet me kontratë.
- Shërbimet e negociuara- në këto shërbime, agjencioni për transfer të mjeteve bën negociata me një numër të caktuar të institucioneve në vende të ndryshme në mënyrë, që të krijojë rrjetin e duhur të pikave fizike. Shembuj të shërbimeve të negociueshme janë marrëveshjet bilaterale mes bankave, unioneve kreditore apo marrëveshjeve postare.
- Shërbimet e hapura- në këto shërbime, një ATP ofron shërbime për klientët e saj në vendin dërgues dhe siguron pika fizike të shërbimit në vendin pranues duke shfrytëzuar një rrjet të hapur në të cilin çdo ATP ka qasje, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Aktualisht një rrjet i tillë është rrjeti ndërkombëtar i bankave, i përbërë nga sistemet e pagesave të vendeve përkatëse në të cilat shtetet tjera mund të kyqen qoftë përmes bankave korrespondente, apo lidhjeve të drejtpërdrejta mes sistemeve të pagesave. Shërbimet e hapura (open services) janë forma më e zakonshme e transferit të remitancave që ofrohet nga ana e bankave.

³ CPSS/World Bank-General principles for remittances- January 2007

2. Çështje kyçe lidhur me shërbimin e remitancave

Pesë karakteristika të tregut të remitancave të cilat mund të shkaktojnë pasiguri dhe jo-efikasitet në tregun e remitancave janë⁴:

- Mungesa e transparencës dhe mirëkuptimit në treg nga ana e palëve;
- Dobësitë në infrastrukturë e cila përdoret në ofrimin e shërbimit për remitanca;
- Mundësia për efekte negative nga rregullat e dobëta apo të papërshtatshme apo nga një kornizë e dobët ligjore;
- Mungesë e kushteve konkurruese në treg; dhe,
- Rreziku.

2.1 Mungesa e transparencës dhe mirëkuptimit

Klientët janë të interesuar të kenë informata të nevojshme për të gjitha tiparet e një transferi të remitancave (çmimi, koha e transferimit, lokacioni ku mund të pranohen mjetet, kursi i këmbimit etj.), në mënyrë që të bëjnë një zgjedhje të informuar. Këto informata iu japin mundësi individëve që të zgjedhin cilin shërbim do ta shfrytëzojnë dhe njëkohësisht të ndikojnë në efikasitetin e tregut të remitancave. Kostoja dhe shpejtësia e kryerjes së transferit janë ndër veçoritë për të cilat janë më së shumti të interesuar klientët, prandaj atyre duhet kushtuar shume kujdes në mënyrë që të jenë sa më transparent. Për momentin tregu i remitancave në përgjithësi nuk është shumë transparent.

2.2 Çështjet e Infrastrukturës

Një tjetër çështje që mund të shkaktojë probleme në funksionimin e tregut të remitancave është infrastruktura. Tregu i remitancave ka nevojë për infrastrukturë të sigurt dhe të përshtatshme në mënyrë që të funksionojë normalisht. Problemet që mund të paraqiten në infrastrukturën e tregut të remitancave janë:

- Krijimi i rrjetit të pikave fizike- kjo paraqet problem për ATP-të për arsye se shtrirja e rrjetit të pikave fizike nëpër vende të ndryshme ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme. Njëra nga mundësitë për eliminimin e këtyre problemeve janë marrëveshjet

⁴ CPSS/World Bank-General principles for remittances- January 2007

me unione kreditore apo banka në mënyrë ,që në objektet e tyre nga vetë ato institucione të kryhet procesi i transferit të mjeteve.

- Dobësitë në infrastrukturën financiare në vendet e origjinës- dihet se vendet nga dërgohen mjetet zakonisht janë vende më të zhvilluara, ndërsa vendet pranuese janë vende në zhvillim, prandaj në vendet e origjinës infrastruktura financiare mund të jetë në nivel jo të zhvilluar dhe mund të shkaktojë probleme në procesin e shpërndarjes së mjeteve.
- Problemet e shpeshta për pagesa ndërkombëtare nga vendet në zhvillim- disa nga vendet në zhvillim ose nuk janë të kyçura në sistemet ndërkombëtare për transfere të parave ose kanë probleme tjera në transferet ndërkombëtare, të cilat nuk mundësojnë funksionim normal të tregut të remitancave.

2.3 Kuadri ligjor dhe rregullativ

Industria e remitancave ashtu si çdo tjetër, do të funksionojë më mirë, nëse baza e përgjithshme ligjore në të cilën operon është e mirë, e parashikueshme, jo diskriminuese dhe proporcionale. Veçanërisht e rëndësishme është zbatimi i kontratave, sidomos në rastet kur palët në kontratë janë në juridiksione të ndryshme.

Qëllimi kryesor i rregullave për remitanca është eliminimi i rreziqeve, parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe arsyeve tjera. Rregullat mund të ndryshojnë nga vendi në vend, varësisht prej veçorive të vendeve përkatëse.

Në Kosovë aktualisht nuk ekziston rregullativë ligjore që mbulon këtë kategori të rëndësishme. Prandaj, marr parasysh faktin se remitancat përbëjnë rreth 11 % të BPV (për vitin 2009)⁵ dhe rreth 40 % të të hyrave familjare⁶, autoritetet përkatëse duhet të hartojnë infrastrukturën ligjore, në mënyrë që të mbrohen qytetarët dhe të përcaktohet mënyra e funksionimit të tregut të remitancave me ligj.

2.4 Mungesa e kushteve konkurruese në treg

Konkurrenca në treg çdo herë rrit efikasitetin e shërbimeve që ofrohen. Nëse në treg do të ketë një numër më të madh të ATP-ve edhe cilësia e shërbimeve që ofrojnë do të jetë më e madhe. Mirëpo, janë të shumta rastet kur ATP-të vendosin kushte mbi ekskluzivitetin, që do të thotë se agjentëve

⁵ Studimi I Remitancave në Kosovë, Nëntor 2010, UBO Consulting, UNDP & USAID KOSOVO, fq.41

⁶ Po aty fq. 41

të ATP-ve ju lejohet ofrimi i shërbimit të remitancave, por me kusht që ata të mos ofrojnë shërbime të tjera për remitancat. Kjo mënyrë e ofrimit të shërbimeve mund të çojë deri te monopolet lokale, pasi që në vendet në zhvillim mund të ketë pak agjent që ofrojnë shërbimin e remitancave, kështu që, me kushtet e ekskluzivitetit ata do të mund të ofronin vetëm një lloj shërbimi për remitanca. Ky problem mund të paraqitet te vendet në zhvillim për shkak të nivelit të ulët të infrastrukturës ligjore.

2.5 Rreziku

Agjencionet për transfere të parave mund të ballafaqohen me rrezikun financiar, ligjor, operacional, të mashtrimit dhe atë reputacional. Vlera e ulët e transfereve të përfshira në remitanca nënkupton që rreziku sistemik nuk mendohet që të ndodh.

Për dërguesit dhe pranuesit e transferit të emigrantëve, rreziku potencial gjatë transferimit të parave është humbja e fondeve përderisa ato janë në proces të transferimit (problemet e falimentimit apo probleme tjera me agjencionin i cili do ti pranonte paratë gjatë transferit).

Rrezik tjetër është edhe fakti se shërbimet për remitanca mund të keqpërdoren për qëllime ilegale siç është pastrimi i parave, financimi i terrorizmit etj dhe për këtë arsye tash institucionet që ofrojnë transferin e dërgesave të emigrantëve këtyre dy dukurive ju kushtojnë një kujdes të veçantë.

3. Parimet e përgjithshme për shërbimet e remitancave ndërkombëtare

3.1 Objektivat e Politikave Publike

Qëllimi i politikave publike lidhur me dispozitat e remitancave është definuar në këtë mënyrë: shërbimet e remitancave duhet të jenë të sigurt dhe efikase. Për këtë qëllim, tregjet për shërbimet e remitancave duhet të jenë jodiskriminuese, transparente, të hapura dhe të qëndrueshme.

Konkurrenca në ofrimin e shërbimeve të remitancave ndihmon në përmirësimin e shërbimeve të ofruara, si dhe në zbritjen e çmimeve kështu që, tregjet e remitancave duhet të jenë të hapura për pjesëmarrës të rinj në to. Tregjet e tilla duhet t'i japin dërguesit dhe pranuesit:

- Informata të qarta për çmimin dhe karakteristikat tjera të shërbimeve (dmth industria e remitancave duhet të jetë transparente);

- Qasje e lehtë në shërbimet e remitancave (dmth industria e remitancave duhet të jetë e lehtë për t'u qasur);
- Mbrojtje e arsyeshme prej dështimeve operacionale dhe abuzimeve kriminale (dmth industria e remitancave duhet të jetë e qëndrueshme).

3.2 Aplikimi i Parimeve bazë

Në mënyrë që të arrihen objektivat e politikës publike, grupi punues ka përcaktuar pesë parimet bazë të cilët mbulojnë pesë fusha kyçe⁷: (1) transparencja dhe mbrojtja e konsumatorit, (2) infrastruktura e sistemit të pagesave, (3) mjedisi ligjor dhe rregullativ, (4) përbërja e tregut dhe konkurrenca; dhe, (5) qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut. Qëllimi i këtyre parimeve është që t'i zvogëlojë mangësitë e tregut dhe të sigurojë një treg efikas dhe të qëndrueshëm.

3.3 Parimet Bazë

3.3.1. Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorëve

Transparenca në shërbimet e remitancave, kombinuar me mbrojtjen e nevojshme për klient, ndihmon në zhvillimin e një tregu të sigurt dhe konkurrues të remitancave.

Siç është përmendur edhe më lart në këtë raport, transparencja e çmimeve dhe karakteristikave tjera të shërbimit të remitancave është thelbësore për krijimin e një tregu efikas të remitancave. Ofruesit e shërbimit të remitancave, me qëllim që të jenë më të kuptueshme për klientët e tyre, duhet të ofrojnë forma të thjeshta në mënyrë, që klientët të kenë qasje të lehtë në to. Nëse është e mundur këto forma duhet të përfshijnë çmimin e përgjithshëm (tarifat e dërgesës dhe pranimit, normat e këmbimit valutor si dhe shpenzimet tjera nëse ka), koha që është e nevojshme derisa mjetet arrijnë te pranuesi dhe lokacionet e pikave fizike të ofruesve të shërbimeve të remitancave (si për dërguesin ashtu edhe për pranuesin). Gjithashtu duhet t'i bëhet e qartë dërguesit të mjeteve nëse ka ndryshim tarifash kur pagesa bëhet me para të gatshme apo përmes llogarisë etj.

3.3.2 Infrastruktura e Sistemit të Pagesave

Shërbimet e remitancave, pos tjerash kërkojnë edhe një sistem të qëndrueshme të pagesave. Në disa vende, veçanërisht në vendet pranuese të remitancave kjo infrastrukturë mbetet e zhvilluar në nivele të ulëta, ku

⁷ CPSS/World Bank-General principles for remittances- January 2007

shërbimet e pagesave pa para të gatshme janë të zhvilluara vetëm në zonat urbane.

Siguria dhe efikasiteti i shërbimit të remitancave mund të ndikohet nga sistemet e pagesave në tregjet përkatëse dhe mënyra se si këto sisteme janë të arritshme dhe të përdorura nga ana e agjencioneve për transfere të parave. Përmirësimet në sistemin e brendshëm të pagesave po ashtu mund të kenë një ndikim pozitiv edhe në efikasitetin dhe sigurinë e sistemit të pagesave ndërkombëtare, përmes përmirësimit të infrastrukturës ligjore, standardeve të komunikimit, formatit të mesazheve për pagesa si dhe elementeve tjera të cilët do të ndikonin në qëndrueshmërinë e sistemit të pagesave.

3.3.3. Mjedisi ligjor dhe rregullativ

Korniza ligjore dhe rregullative përfshin infrastrukturën e përgjithshme ligjore (siç janë ligjet që kanë të bëjnë me kontratat, pagesat, letrat me vlerë, punët bankare etj.) dhe statutet e veçanta, praktika gjyqësore, rregullore apo kontrata (psh rregulloret e sistemit të pagesave) që kanë të bëjnë me remitancat.

Në remitanca janë të përfshira së paku dy juridiksione: juridiksioni i vendit të origjinës dhe destinacionit të emigrantit. Autoritetet e një vendi të caktuar munden, natyrisht të kenë ndikim në ligjet e vendit të tyre. Por pa marr parasysh këtë, nëse ata janë të shqetësuar për ndonjë çështje të vendit tjetër, ata mund të punojnë me autoritetet e vendit përkatës në mënyrë që ta zgjidhin atë problem.

Një rëndësi të veçantë në këtë aspekt kanë rregullat që kanë të bëjnë me politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të remitancave duhet të jenë në përputhje të plotë me këto politika.

3.3.4. Përbërja e tregut dhe konkurrenca

Efikasiteti i shërbimit të remitancave varet nga ekzistimi i një mjedisi konkurrues biznesor. Tregjet konkurruese do të çojnë në kufizimin e monopoleve dhe në zvogëlimin e çmimeve të shërbimeve po ashtu edhe në rritjen e nivelit të shërbimeve. Konkurrenca mund të ndihmohet duke kufizuar agjencionet për transfer të parave që të japin të drejta ekskluzive për agjenci të ndryshme.

Për të ofruar shërbimin e transferit të remitancave, ATP-të zakonisht duhet të kenë qasje në infrastrukturën e sistemeve kombëtare të pagesave. Qasja mund të jetë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë. Kështu që, cilado formë qoftë

ATP-të, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pasi që ato janë konkurrent mes veti dhe qasja në sisteme të pagesave mund të jetë faktor ,që do të ndikojë në garën mes tyre.

3.3.5. Qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut

Qeverisja e përshtatshme dhe praktikat e menaxhimit të rrezikut nga ana e agjencioneve për transfer të parave, mund të përmirësojnë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimit të remitancave dhe të ndihmojnë në mbrojtjen e konsumatorit. Kështu që, agjencionet për transfer të parave duhet t'i adaptojnë standardet për qeverisje të mirë në përputhje me ligjet e vendit në të cilin operojnë dhe që t'i ndjekin praktikat më të mira për të zhvilluar një treg sa më të sigurt dhe efikas të remitancave.

Si në industrinë e pagesave në përgjithësi, industria e remitancave ndërkombëtare ballafaqohet me rrezikun ligjor, financiar, operacional, të mashtrimit apo edhe rrezikun e reputacionit. Në vendosjen e masave për kontroll të rrezikut, ofruesit e shërbimeve të remitancave duhet të kryejnë vlerësimin e nivelit të rrezikut në mënyrë, që të sigurohen që masat për kontroll të rrezikut janë të përshtatshme për nivelin e rrezikut dhe biznesit në përgjithësi. Duke vepruar në këtë mënyrë, ata duhet sa më shumë të jetë e mundur të marrin masat e duhura për të mbrojtur veten dhe klientët e tyre kundër rrezikut, që rrjedh nga operacionet e tyre në juridiksione të ndryshme, veçanërisht në ato me mangësi në kornizën e tyre ligjore dhe rregullative.

3.4 Roli i agjencioneve për transfer të parave dhe autoriteteve publike

Edhe pse rrethanat ndryshojnë nga vendi në vend, agjencionet për transfer të parave dhe autoritetet publike kanë përgjegjësi për implementimin e parimeve në mënyrë që të arrihen objektivat e politikës publike.

- ***Roli i agjencioneve për transfer të parave- pjesëmarrja aktive në implementimin e parimeve të përgjithshme***

ATP-të duhet të përpiqen t'i përmbahen parimeve të përgjithshme për dërgesat e emigrantëve. Ata duhet përpjekur që në Kosovë të ofrojnë shërbime konkurruese dhe efikase në mënyrë që t'i plotësojnë kërkesat e klientëve të tyre. Për të qenë sa më transparent ATP-të në Kosovë duhet të bëjnë publike çmimet e tyre, duke përfshirë edhe provizionet me të cilët ngarkohen ata, po ashtu duhet të tregojnë edhe kohën e kryerjes së transferit. ATP-të në Kosovë duhet të sigurohen që veprojnë në përputhshmëri të plotë me legjislacionin vendas, kujdes i veçantë duhet

kushtuar pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dy nga çështjet që i kushtohet më shumë rëndësi nëpër botë.

- ***Roli i autoriteteve publike- autoritetet publike duhet të vlerësojnë çfarë veprime duhet të ndërmerren që të arrihen objektivat e politikës publike përmes implementimit të Parimeve të Përgjithshme të përcaktuara si më lartë***

Kur politikëbërësit vendosin që të ndërmarrin veprime në lidhje me remitancat duke iu përmbajtur parimeve, autoritetet relevante duhet të kenë fuqi dhe burime të mjaftueshme. Janë mjete të shumta që mund të përdoren nga autoritetet publike, varësisht nga niveli i involvimit të autoriteteve që dëshirojnë të ndërmarrin. Këto mjete përfshijnë monitorimin, dialogun me sektorin privat dhe dhënien e informacioneve për publikun. Kur implementimi i parimeve përfshin disa autoritete të brendshme, politikëbërësit duhet të sigurojnë, që politikat e brendshme janë të koordinuara dhe që autoritetet bashkëpunojnë në të njëjtën politik dhe nivel të implementimit. Në rastet kur ka mundësi, bashkëpunimi ndërkufitar është i mirëseardhur.

3.5. Formulimi i qasjes për implementim të parimeve të përgjithshme

Implementimi i parimeve të përgjithshme mbetet njëra nga sfidat kryesore për agjencionet për transfer të parave. Përgjegjësia për implementimin e parimeve i takon si sektorit publik ashtu edhe sektorit privat.

Mjetet për zbatimin e parimeve të përgjithshme

Autoritetet publike mund të marrin masa për shërbimet e remitancave në mënyra të ndryshme, varësisht sa vlerësojnë se duhet të jetë involvimi i tyre në ato çështje⁸.

- Monitorimi do të ndihmonte në arritjen e objektivave të politikës publike dhe marrjen e masave të duhura në lidhje me industrinë e remitancave. Ndryshimet në tregun e remitancave ngritin rëndësinë e monitorimit, e cila mund të fokusohet në mënyrën se si janë duke evoluuar remitancat.
- Dialogu me sektorin privat është një mjet i rëndësishëm që mund të përdoret për kuptimin e trendëve të tregut. Bisedimet duhet t'i përfshijnë të gjitha palët e interesuara kështu që, vërejtjet e gjithë pjesëmarrësve janë marrë parasysh.

⁸ CPSS/World Bank-General principles for remittances- January 2007

- Komunikimi dhe kontaktimi janë të lidhura me dialogun por meritojnë një kujdes të veçantë, pasi që përfshijnë rritjen e vetëdijëesimit përmes agjencioneve për transfer të parave, që ato mund të ofrojnë shërbime efikase dhe të sigurta për klientët e tyre në mënyrë që të rrisin shfrytëzimin e produkteve financiare.
- Autoritetet duhet të kenë mundësi që të ndihmojnë sektorin privat në përmirësimin e tregut të remitancave duke vepruar si katalizator. Psh. duke përcaktuar rregullat apo ligjet në bazë të të cilave ata duhet të operojnë.
- Autoritetet publike mund të kenë nevojë të rishqyrtojnë disa herë rregulloren për të evituar dështimet e tregut. Kur veprojnë në këtë mënyrë, duhet që të sigurojnë që veprimet e tyre sjellin përfitime dhe nuk krijojnë pengesa të panevojshme për shërbimet e remitancave. Autoritetet mund t'i rishikojnë rregullat që të sigurojnë se ato nuk janë të pa aplikueshme dhe se nuk diskriminojnë agjencionet për transfer të parave.
- Dispozitat e drejtpërdrejta nga ana e autoriteteve publike për shërbime të caktuara, që t'i përkrahin funksionimin e remitancave janë gjithashtu një instrument i mundshëm edhe pse shpesh kjo do të ishte e dëshirueshme vetëm kur instrumentet tjera tregohen joefikase.

4. Situata aktuale e remitancave në Kosovë

4.1 Ecuria e zhvillimeve dhe kanalet e transferit të parasë

Migrimi i shqiptarëve nga Kosova ka filluar qysh në kohët e ish-Jugosllavisë. Faza e parë e migrimit të shqiptarëve nga Kosova llogariten vitet e '60-'70, kur për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike në Kosovë, shumë qytetar ishin të detyruar që të migronin në vende tjera qoftë brenda apo jashtë federatës në kërkim të mundësive të reja për punë. Faza e dytë përfshin periudhën nga vitet '89 ku pati migrime masive të shqiptarëve nga Kosova drejt vendeve perëndimore. Arsye të këtyre migrimeve ishin sa ekonomike aq edhe politike. Faza e tretë përfshin periudhën pas vitit 1999 kur Kosova e sapo dalë nga lufta u ballafaqua me krizë të madhe ekonomike. Fabrikat e shkatërruara, infrastruktura e pazhvilluar, mungesa e energjisë elektrike dhe niveli i lartë i papunësisë ishin ndër faktorët kryesor, që ndikuan në vazhdimin e migrimit të qytetarëve të Kosovës.

Kosova me një normë kaq të lartë të papunësisë që besohet të jetë rreth 37-40.7%⁹ është e varur në masë të madhe nga dërgesat e emigrantëve. Shumica e emigrantëve janë të koncentruar në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vendet tjera më të zhvilluara të Evropës e Botës. Kriza ekonomike që ka përfshirë botën vitet e fundit padyshim, se ka ndikuar në gjendjen financiare edhe të emigrantëve kosovar duke ndikuar kështu edhe në sasinë e mjeteve që dërgojnë ata në vend. Për dërgimin e mjeteve të tyre emigrantët shfrytëzojnë rrugë të ndryshme që në përgjithësi ndahen në dy grupe kryesore: rrugët formale dhe joformale të dërgimit të parave.

4.2 Forma Formale e Dërgimit të Remitancave

Struktura e punëve të cilat kryejnë emigrantët kosovar nëpër vendet perëndimore është e ndryshme. Kështu, këta emigrantë shfrytëzojnë mënyrat më të lehta për dërgimin e mjeteve edhe pse shpesh ato nuk janë shumë të sigurta. Mirëpo është edhe pjesa tjetër e emigrantëve të cilët, si parakusht për dërgimin e mjeteve të tyre e përcaktojnë sigurinë para kostos apo faktorëve tjerë.

Transferi përmes agjencioneve të specializuara për transfer të parave mbetet njëra nga mënyrat e preferuara për transfere të emigrantët. Këto agjencione janë të shpërndara pothuaj në të gjitha zonat nëpër Kosovë, duke ju mundësuar klientëve të tyre qasje të lehtë për pranim të parave. Këto agjencione ofrojnë dërgim të shpejtë të parave por kostoja e dërgimit është relativisht e lartë. Ato kanë numër të madh agjentësh të cilët janë të shpërndarë nëpër zonat urbane e po ashtu edhe nëpër zona rurale.

⁹ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Puna Dhe Punësimi, Raporti Vjetor 2010


Tabela 1. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes agjencioneve për transfer të parave

Viti	Shuma (në milion Euro)	Pjesmarrja në total (%)
2006	184.7	39.5
2007	198.7	38.5
2008	213.1	35.0
2009 TM1	46.3	38.0
TM2	53.3	37.5
TM3	53.0	30.3
TM4	60.5	41.2
2010 TM1	46.3	38.4
TM2	53.3	36.8
TM3	53.0	32.1
TM4	60.5	39.4
2011 TM1	50.1	40.1
TM2	55.1	39.9
TM3	55.7	33.8
TM4	64.5	41.2
2012 TM1	47.1	39.5
TM2	55.0	38.6
TM3	52.0	29.7
TM4	64.5	38.2

Burimi: BQK (2013)

Në Tabelën 1 janë paraqitur vlerat e remitancave të dërguara përmes agjencioneve për transfer të parave në Kosovë gjatë periudhave 2006-2012. Nga tabela vërejmë se ka pasur ndryshime të vazhdueshme të shumës së mjeteve të dërguara përmes ATP-ve. Gjatë tremujorit të katërt 2012 ka pasur shumë thujse të njëjtë të remitancave të dërguara përmes ATP-ve, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku gjatë këtij tremujori përmes tyre janë dërguar 64.5 milionë euro.

Grafiku 1. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes agjencioneve për transfer të parave (në milion Euro)



Burimi: BQK (2013)

Transferi përmes llogarive bankare u mundëson klientëve transfer të parave nga vendi i destinacionit në vendin e origjinës së emigrantit. Kjo mbetet ndër format më të sigurta për dërgim të parave. Bankat janë të lidhura me rrjetin ndërkombëtar për telekomunikim financiar të quajtur SWIFT, që u mundëson bankave dërgim të mesazheve në mënyrë që të kryejnë pagesa nga vendet e ndryshme. Bankat tona në mungesë të lidhjeve të drejtpërdrejta me banka në vende të ndryshme, shfrytëzojnë bankat ndërmjetësuese (të cilat zakonisht janë banka të njohura botërore) për kryerjen e këtyre pagesave. Transferët që kryhen përmes llogarive janë mjaft të sigurta por kanë një kosto më të lartë, pasi që duhet të paguhet tarifa e bankës urdhëruese, bankës ndërmjetësuese si dhe bankës pranuese. Edhe koha për kryerjen e transferëve është më e gjatë pasi që përfshihen tri institucione. Klientët preferojnë dërgimin e parave përmes llogarive bankare në rast kur kanë pagesa në vlera më të mëdha për shkak të sigurisë dhe koston. Edhe pse transferi përmes llogarive bankare është më shumë i preferuar për transfere nga ana e bizneseve, megjithatë kjo formë mbetet mjaft e rëndësishme edhe për transferet e emigrantëve.

Tabela 2. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes llogarive bankare


Viti	Shuma (në milion Euro)	Pjesmarrja në total (%)
2006	135.1	28.9
2007	137.1	26.6
2008	126.3	20.8
2009 TM1	32.4	26.6
TM2	30.9	21.7
TM3	58.0	33.2
TM4	27.5	18.7
2010 TM1	34.1	28.2
TM2	33.4	23.0
TM3	43.8	26.6
TM4	30.1	19.6
2011 TM1	30.3	24.2
TM2	25.2	18.2
TM3	48.9	29.7
TM4	35.2	22.5
2012 TM1	23.3	19.6
TM2	21.8	15.3
TM3	56.3	32.2
TM4	25.1	14.9

Burimi: BQK (2013)

Nga tabela 2 konstatohet se shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes rrugëve bankare ka pasur ngritje dhe rënie nga viti në vit. Në vitin 2008 ka pasur një rënie të lehtë të shumës së remitancave që dërgohen

përmes llogarive bankare, qoftë për arsye të krizës ekonomike në vendet perëndimore, qoftë për shkak të kostos së lart dhe kohës së gjatë për kryerjen e transferit të këtyre mjeteve nga vendi i destinacionit në vendin e origjinës. Në vitin 2009 konstatohet ngritje e shumës së dërgesave të emigrantëve të dërguara përmes llogarive bankare, por në vitet pasuese shuma e remitancave të dërguara përmes transfereve bankare ka pasur rënie. Në vitin 2011 krahasuar me një vit më parë, shuma e remitancave përmes llogarive bankare ka pasur rënie prej 1.1%, ndërsa në vitin 2012 rënia ka qenë rreth 9.4%. Transferi përmes llogarive bankare për transfere ndërkombëtare mbetet më i preferuari për transferet në vlera më të mëdha për shkak të kostos më të ulët (në krahasim me agjencionet për transfer të parave), si dhe rruga më e përshtatshme për pagesa të mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 2. Shuma e remitancave të dërguara në Kosovë përmes llogarive bankare (në milion Euro)



Burimi: BQK (2013)

4.3 Forma jo-formale e dërgimit të remitancave

Përpos formës formale, përdoret edhe forma joformale për dërgimin e remitancave. Kjo nënkupton bartjen e parave kesh kur emigrantët kthehen në Kosovë apo dërgimin e parave përmes të njohurëve të tyre.

Transferi kesh i parave ka qenë dhe mbetet ndër format më shumë të shfrytëzuara nga emigrantët kosovar për transfere të mjeteve. Kjo një herë është edhe forma më e vjetër edhe jo shumë e sigurt për transfer të parave. Shpesh emigrantët për arsye të ndryshme (përfshirë koston dhe arsye të tjera) vendosin që paratë e tyre t'i bartin kesh gjatë udhëtimit në Kosovë apo përmes të afërmeve të tyre t'i dërgojnë deri këtu. Arsye tjetër pse

emigrantët bëjnë transfer kesh të parave është edhe se ka nga ata, që nuk kanë dokumente të rregullta qëndrimi dhe nuk mund të kenë qasje në banka apo institucione tjera për transfer të parave. Besohet që transferi kesh i parave përfshin vëllim mjaft të madh të dërgesave që emigrantët dërgojnë në Kosovë. Është e pamundur të përcaktohet në mënyrë të saktë numri dhe vëllimi i këtyre transaksioneve pasi që gjithçka kryhet në mënyrë private. Një arsye tjetër shumë e rëndësishme pse emigrantët bëjnë transfer kesh të parave është edhe arsyeja e humbjes së besimit në institucione financiare për shkak të çrregullimeve, që ka pasur sistemi financiar në kohën e ish-Jugosllavisë.

Besohet se një pjesë e madhe e remitancave në Kosovë vazhdojnë edhe më tutje të vijnë përmes kanaleve joformale, që paraqet vështirësi për llogaritjen e sasisë së mjeteve, që janë rezultat i remitancave dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Disa nga arsyet pse zgjidhet mënyra joformale e dërgimit të remitancave janë:

- Kostoja e lartë e transferit të parave;
- Mungesa e bankave apo e agjencioneve për transfere në zonat rurale;
- Pengesat në hapjen e llogarive në vendet e destinacionit të emigrantëve, kryesisht për shkak të migrimeve ilegale;
- Mungesa e besimit në sistemin financiar si rezultat i zhvillimeve negative në bankat e ish-Jugosllavisë gjatë viteve të '90-ta;

Në bazë të një studimi të bërë nga UBO Consulting e përkrahur nga UNDP dhe USAID, rezulton se gjatë vitit 2009, 42 përqind e remitancave kanë ardhur përmes kanaleve zyrtare, ndërsa 58 përqind e remitancave përmes kanaleve jozyrtare. Gjatë transferit përmes kanaleve jozyrtare emigrantët kanë shfrytëzuar dy rrugë kryesore: i kanë dërguar mjetet vet personalisht gjatë vizitave në vendlindje, apo mënyra tjetër përmes të afërmeve e miqve të tyre.

4.4 Remitancat sipas kanaleve të pranimit

Nga tabela 3 shihet se cilat rrugë të transferit të parave i shfrytëzojnë aktualisht dhe cilat i kanë shfrytëzuar ndër vite emigrantët kosovar. Në bazë të të dhënave të tabelës 3 mund të konstatohet se rruga më e preferuar dhe më shumë e shfrytëzuar nga ana e emigrantëve tanë gjatë vitit 2012 ka qenë transferi përmes formave joformale, pasuar nga transferet përmes agjencioneve për transfer të parave dhe pastaj alternativa tjetër dhe më pak e përdorur janë transferet bankare.

Tabela 3. Remitancat sipas kanaleve të dërgimit (në milion euro)

Viti	Përmes Bankave	Përmes Operatorëve	Përmes rrugëve tjera	Totali
2004	N/A	N/A	N/A	357.0
2005	N/A	N/A	N/A	418.0
2006	135.1	184.7	147.3	467.1
2007	137.1	198.7	179.8	515.6
2008	126.3	213.1	269.3	608.7
2009	148.8	213.1	223.8	585.7
2010	141.3	213.1	229.9	584.3
2011	139.7	225.3	219.8	584.8
2012	126.5	218.5	260.6	605.6


Burimi: BQK (2013)

Arsyet pse emigrantët zgjedhin agjencionet për transfer të parave si mënyrën e parë formale të dërgimit të mjeteve janë të ndryshme por mund të përmenden disa nga ato:

- Qasja e lehtë në lokacionet e këtyre agjencioneve (si në vendin e origjinës ashtu edhe në vendin e destinacionit të emigrantit);
- Procedura të thjeshta (pa burokraci gjatë transferit të mjeteve nga dërguesi të pranuesi);
- Koha (këto agjencione mundësojnë transferin e mjeteve për një kohë relativisht të shkurtër;) etj.

Gjatë vitit 2006 rreth 29 përqind e remitancave janë dërguar përmes bankave, 39 përqind përmes agjencioneve dhe rreth 32 përqind përmes rrugëve tjera. Gjatë vitit 2007 rreth 27 përqind të remitancave janë dërguar përmes rrugëve bankare, 38 përqind përmes operatorëve dhe rreth 35 përqind përmes rrugëve tjera. Pra trendi ka qenë pothuaj i njëjtë me kalimin e viteve, duke mbetur prapa gjithnjë rruga e dërgimit të mjeteve përmes llogarive bankare si mënyra më e sigurt. Gjatë vitit 2012 transferët e remitancave përmes bankave patën një rënie të theksuar ku në këtë vit vetëm 21 përqind e remitancave në Kosovë u dërguan përmes bankave, 36 përqind përmes ATP-ve ndërsa pjesa tjetër prej 43 përqind përmes rrugëve tjera të transferit të mjeteve.


Grafiku 3. Remitancat sipas kanaleve të dërgimit (në milion euro)



Burimi: BQK (2013)

Në Grafikon 4 është paraqitur vlera e përgjithshme e remitancave në Kosovë gjatë viteve 2004-2012. Nga viti 2004 deri në vitin 2008 pati ngritje të vazhdueshme të remitancave të dërguara në Kosovë, nëse bëjmë një krahasim në përqindje vërejmë se në vitin 2007 kishim 10.4 përqind më shumë para të pranuar se në vitin 2006. Pastaj në vitin 2008 pati 18.1 përqind rritje në remitanca në krahasim me 2007, në vitin 2009 kishim rënie prej 3.8 përqind të remitancave në krahasim me 2008, në vitin 2010 ka patur rënie prej rreth 0.24 përqind në krahasim me 2009. Kjo është periudha kur në vendet e zhvilluara vazhdonte kriza ekonomike, e cila pati dhe vazhdon të ketë ndikim edhe sot në vlerën e remitancave që dërgohen në vend. Në vitin 2011 pati rritje shumë të lehtë të remitancave të dërguara në krahasim me vitin 2010, trendët rritesëse janë edhe për vitin 2012, ku gjatë këtij viti shuma e remitancave të dërguara u rrit për 3.6% krahasuar me një vit më parë. Të gjithë këto të dhëna më së miri mund të vërehen edhe nga grafiku 4, ku është paraqitur ecuria e remitancave që nga viti 2004 e deri në vitin 2012.

Grafiku 4. Remitancat sipas viteve (në milion Euro)



Burimi: BQK (2013)

4.5 Vendet Dërguese të Remitancave

Emigrantët nga Kosova kanë emigruar kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian për shkak të nivelit më të zhvilluar ekonomik dhe standardit më të lartë të jetës. Mendohet se numri i atyre që kanë emigruar nga Kosova të jetë mbi 400 000¹⁰, por nuk ka ndonjë shifër të saktë për numrin e emigrantëve nga Kosova në vendet tjera. Pjesa më e madhe e emigrantëve janë të vendosur në Gjermani (27%), Zvicër (24%), SHBA (9%), Angli (6%), Itali (5%), Francë (4.8%), Suedi (4%)¹¹. e në vende tjera të zhvilluara. Nga tabela 5 shihet përqindja e remitancave të ardhura nga çdo shtet në krahasim me totalin e remitancave. Kështu, gjatë TM4 të vitit 2012 remitancat e ardhura nga Gjermania përbënin afërsisht 34% të totalit të remitancave të pranuar në Kosovë, nga Zvicra rreth 21% nga Italia mbi 9% nga Austria 6% nga SHBA-ja mbi 4%. Pra, nga vendet ku ka më shumë emigrantë edhe shuma e remitancave të dërguara është më e madhe, gjë që është lehtë e kuptueshme. Shumat e remitancave që kanë ardhur nga Gjermania viteve të mëparshme, kanë pasur trendë të ulëta lëvizjeje, me ngritje dhe rënie të lehta.

¹⁰ World Bank, The World Bank Kosovo Poverty Assessment, Volume I: Accelerating Inclusive Growth to Reduce Widespread Poverty (3 October 2007)

¹¹ Studimi i Remitancave në Kosovë, Nëntor 2010, UBO Consulting, UNDP & USAID KOSOVO, fq.26

Tabela 4. Vendet nga vijnë remitancat në

	2008	2009				2010				2011				2012			
		TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Gjermani	38%	35%	39%	37%	38%	35%	35%	33%	34%	33%	33%	34%	34%	31%	37%	35%	34%
Zvicër	16%	21%	20%	21%	22%	21%	21%	21%	22%	24%	23%	23%	22%	24%	26%	23%	21%
Itali	13%	11%	11%	10%	10%	9%	8%	7%	7%	7%	7%	6%	7%	5%	8%	8%	9%
Austri	6%	5%	6%	6%	5%	6%	4%	7%	5%	6%	6%	6%	5%	6%	6%	6%	6%
Belgjikë	3%	4%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	2%	3%	3%	1%	7%	3%	3%
SHBA	3%	3%	3%	3%	2%	4%	5%	5%	3%	5%	4%	2%	4%	6%	4%	4%	4%
Suedi	4%	3%	3%	4%	3%	3%	3%	3%	4%	4%	3%	4%	3%	4%	1%	3%	3%
Francë	4%	3%	4%	4%	4%	3%	4%	4%	4%	4%	4%	4%	4%	3%	0%	3%	3%
Norvegji	2%	3%	2%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	5%	1%	3%	2%
Kanada	2%	2%	2%	2%	2%	1%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	1%	0%	1%	2%
Britani e Madhe	1%	2%	1%	1%	1%	2%	2%	2%	1%	2%	1%	1%	1%	3%	2%	2%	2%
Danimark	2%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	0%	1%	1%
Finlandë	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	0%	1%	1%
Holandë	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	0%	0%	1%	0%
Sloveni	1%	1%	1%	2%	1%	3%	4%	6%	4%	4%	4%	3%	4%	5%	5%	4%	4%
Vendet tjera	3%	4%	1%	2%	2%	4%	6%	3%	5%	3%	6%	7%	5%	5%	1%	4%	6%

Burimi: BQK (2013)

5. Rekomandime

Efikasiteti dhe siguria mbeten dy objektivat kryesore që duhet t'i përmbushin institucionet që ofrojnë shërbimet e remitancave. Në përmbushjen e këtyre objektiveve ndikon baza ligjore dhe mbikëqyrja që ndërmerr Banka Qendrore përmes autorizimeve që ia përcakton ligji.

Në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe siguria në transfere të emigrantëve rekomandohet:

- **Fushatë për vetëdijesim të emigrantëve që të shfrytëzojnë mënyrat formale të transfereve-** e cila duhet të ketë mbështetje nga BQK-ja, Ministria e Diasporës, Ministria e Financave dhe bankat komerciale. Fushata mund të organizohet nga BQK-ja, Ministria e Diasporës, SHBK-ja si dhe agjenci e institucione tjera, me ç'rast do të përgatiteshin broshura informative për emigrantë gjatë sezonit të verës dhe të cilat do të mund të vendoseshin tek të gjitha bankat dhe në qendra tregtare si vende më të frekuentuara nga emigrantët.
- **Shpërndarja e pikave të agjencioneve për transfer të parave edhe në zona rurale.** Është e njohur se bankat dhe agjencionet për transfer të mjeteve janë kryesisht të vendosura nëpër zonat urbane, kështu që qasja për banorët e zonave rurale është e vështirë për shkak të infrastrukturës dhe faktorëve tjerë. Do të ishte e mirëseardhur për banorët e këtyre zonave hapja e pikave edhe nëpër zonat e tyre.
- **Shtrirja e rrjetit të ATM dhe POS terminaleve nëpër zona rurale** që të lehtësohet qasja edhe për banorët e këtyre zonave. Aktualisht në Kosovë ATM dhe terminalët POS janë të koncentruar nëpër zona urbane, ndërsa në zona rurale rrallë mund të gjendet ndonjë prej tyre. Mungesa e lidhjeve dhe kostoja e mirëmbajtjes konsiderohen si faktorët, që kanë ndikuar në numrin e vogël të ATM-ve dhe POS terminaleve në zona rurale;
- **Pajisja e Kosovës me SWIFT Code** –BQK-ja në mënyrë të vazhdueshme është përpjekur për çështjen e SWIFT Codit, por kanë qenë rrethanat politike ato që i kanë mohuar mundësinë e pajisjes me këtë kod. Pajisja e Kosovës me SWIFT CODE do të zvogëlonte koston e transfereve nga jashtë pasi që bankat komerciale nuk do të shfrytëzonin dhe paguanin për SWIFT CODE të vendeve tjera dhe transferet do të kryheshin më lehtë dhe më shpejt;

- **Ulja e tarifave për transferët hyrëse nga vendet perëndimore** nga ana e bankave dhe agjencioneve të specializuara për transfere ndërkombëtare, e kjo do të ndikonte në masë të madhe në uljen e vëllimit dhe numrit të transfereve joformal;
- **Rritja e konkurrencës-licencimi** i agjencioneve tjera për transfer të parave.
- **Hartimi i rregullativës ligjore për remitanca-BQK-ja** në koordinim me akterë tjerë duhet të hartojë një dokument, i cili do të përcaktonte mënyrën e funksionimit të tregut të remitancave në Kosovë. Në këtë mënyrë do të definoheshin në mënyrë të qartë të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në tregun e remitancave dhe njëkohësisht klientët do të jenë më të mbrojtur nga abuzimet e mundshme.

Bibliografia

- CPSS/World Bank-General principles for remittances- January 2007
- *The Italy-Albania Remittance Corridor, Shifting from the Physical Transfer of Cash to a Formal Money Transfer System*, March 2006, Bari, Italy
- *Foreign Remittances and Poverty Reduction in Kosovo*, Irina Shaorshadze & Sachiko Miyata, November, 2010.
- *Kosovo Remittance Study 2010*, UBO Consulting, USAID & UNDP Kosovo, November, 2010